



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 40

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 11 tetor 2018

## PËRMBAJTJA

|                                                                           | Faqe                                                                          |
|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 6760, datë 11.10.2018 | Për pozicionet e lira të punës në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 3 |

**NJOFTIM****Nr. 6760, datë 11.10.2018****PËR POZICIONET E LIRA TË PUNËS  
NË KOMISIONIN E PAVARUR TË  
KUALIFIKIMIT**

**Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall 8 vende vakante për pozicionin Këshilltar Ekonomik në këtë institucion.**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Kategoria e pagës: 80% e G3

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi jashtë vendit dhe të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të kenë shtatë vite përvojë pune në sektorin financiar.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-të premten, ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

**Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall 2 vende vakante për pozicionin Përkthyes.**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Përkthyesit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Kategoria e pagës: II-b

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, preferohet në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi;

b) Të kenë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip–anglisht–shqip;

c) Të kenë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;

d) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos ketë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.



- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premten ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

### **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall 2 vende vakante për pozicionin Specialist i Sekretarisë Gjyqësore në këtë institucion.**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Kategoria e pagës: III-b

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në drejtësi;
- b) Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- c) Të kenë të paktën tri vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premten, ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

### **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall 1 vend vakant për pozicionin Specialist Protokolli/Arkivi**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të Protokollit/Arkivit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Kategoria e pagës: IV-a

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë;
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;



c) Të ketë të paktën tri vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidati duhet të ketë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e

kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2018**